

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), dhe në lidhje me nenin 98, paragrafi (2) nga Ligji në fjalë, neni 14, paragrafi (4) të Rregullores për teknikat e reja të reklamimit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 56/15), pika 5 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.ark. 01-4241/1 të datës 01.10.2025, Raportin me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer programore nr.ark. 10-2416/1 të datës 9.6.2026 dhe Konkluzionin nr.ark. 02-2680/5 të datës 08.07.2026, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 24-ët të mbajtur më 08.07.2026, miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrjen e masës - paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (ShTR) TELEVISIONI MAKPETROL ShPKNJ P Shkup, për shkak të shkeljes së nenit 98, paragrafi (2) të Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LShMAAV) dhe nenit 14, paragrafi (4) të Rregullores për teknikat e reja të reklamimit (RrTRR), në mënyrë që në kuadër të shërbimit programor televiziv të transmetuar më 4 maj 2026, në emisionin dokumentar argëtues "Aventurat e Markut" (Aventurite na Mark) dhe në programin argëtues humoristik "Ruga ime drejt suksesit" (Mojot pat do uspehot), u transmetuan pop-ap/reklama në ekran të ndarë midis të cilave nuk kaloi periudha e përcaktuar prej së paku 15 minutash.

Shkelja e përmendur në paragrafin (1) të kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark. 10-2416/1, të datës 09.06.2026, i cili është pjesë përbërëse e këtij Vendimi si Shtojca nr. 1.

2. URDHËROHET që ShTR TELEVISIONI MAKPETROL ShPKNJ P Shkup, në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi, të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e LShMAAV-së dhe RrTRR.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit konsiderohet dita e certifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

Arsyetim

Agjencia, në bazë të nenit 28 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LShMAAV), është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve audiovizuele me kërkesë, si dhe të paketave programore të ritransmetuara nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave të këtij ligji, lejet, certifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe aktet e tjera të miratuara nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LShMAAV-së, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesi) ndërmerr masë - paralajmërim publik në rastet kur është kryer cënim ose shkelje e dispozitave të LShMAAV-së dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara nga leja dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 98, paragrafi (2) të LShMAAV-së, rregullat për teknikat e reja të reklamimit përcaktohen nga Agjencia, në pajtim me nenin 14, paragrafi (4) të RrTRR, midis dy reklamave të transmetuara në ekran të ndarë duhet të kalojë periudhë prej së paku 15 minutash.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Agjencia, përmes Sektorit për çështje programore, më 8 qershor 2026, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) mbi shërbimin programor televiziv të ShTR TELEVISIONI MAKPETROL ShPKNJ P Shkup, të transmetuar më 4 maj 2026, në nivel shtetëror, gjatë së cilës u konstatua shkelje të nenit 98, paragrafi (2) të LShMAAV-së dhe nenit 14, paragrafi (4) të RrTRR.

Konkretisht, nga mbikëqyrja u konstatua se më 4 maj 2026, në shërbimin programor të ShTR TELEVISIONI MAKPETROL ShPKNJ P Shkup, në emisionin dokumentar argëtues "Aventurat e Markut" (Aventurite na Mark) dhe në

programin argëtues humoristik "Ruga ime drejt suksesit" (Mojot pat do uspehot), u transmetuan pop-ap/reklama në ekran të ndarë midis të cilës nuk ka kaluar periudha e përcaktuar prej së paku 15 minutash.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark. 10-2416/1 të datës 09.06.2026, i cili është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojca nr. 1.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (3) të LShMAAV-së, Këshilli i Agjencisë i dërgoi ShTR TELEVISIONIT MAKPETROL ShPKNJ P Shkup më 11.06.2026 Shkresë nr.ark.10-2416/2 të datës 11.06.2026, me të cilën i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark.10-2416/1 të datës 09.06.2026, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë t'i paraqesë deklaratë me shkrim për shkellen e kryer të dispozitave nga LShMAAV-së dhe RrTRR. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 12.06.2026. Në afatin e parashikuar, përkatësisht më 12.06.2026, ShTR TELEVISIONI MAKPETROL ShPKNJ P Shkup i dorëzoi Agjencisë deklaratë me shkrim, nr. ynë ark.10-2416/3 të datës 12.06.2026. Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 08.07.2026, shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe deklaratën me shkrim të paraqitur nga transmetuesi dhe arriti në përfundimin se ndaj ShTR TELEVISIONI MAKPETROL ShPKNJ P Shkup, t'i shqiptohet masë - paralajmërim publik.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LShMAAV-së, dhe në lidhje me nenin 98, paragrafi (2) të Ligjit të njëjtë, nenin 14, paragrafi (4) të Rregullores për teknikat e reja të reklamimit, pika 5 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar), Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark.10-2416/1 të datës 09.06.2026 dhe Konkluzionin nr.ark.02-2680/5 të datës 08.07.2026, për shkak të mosrespektimit të dispozitave të LShMAAV-së dhe RrTRR, të përcaktuara në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 08.07.2026, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron ShTR TELEVISIONI MAKPETROL ShPKNJ P Shkup dhe urdhëron që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e LShMAAV-së dhe RrTRR. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LShMAAV-së, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij Aktvendimi transmetuesi ka të drejtë të ngrejë padi, për iniciimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente. Padia për iniciimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojca (1):

- 1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer programore nr.ark. 10-2416/1 të datës 09.06.2026.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi, transmetuesi ka të drejtë të ngrejë padi, për iniciimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente. Padia për iniciimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Përktheu: Antonea Shabani